

VENDIM
Nr. 404, datë 3.5.2017

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “PËR NDËRTIM KOPSHTESH DHE AMBULANCASH NË TERRITORIN E BASHKISË URA VAJGURE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Për ndërtim kopshtesh dhe ambulancash në territorin e Bashkisë Ura Vajgure”.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Ura Vajgure.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë tokë “trual”, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 156 100 (njëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind) lekësh.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 156 100 (njëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind) lekësh, të përballohet nga fondet e Bashkisë Ura Vajgure.
 5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2017, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.
 6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe të përfundojë me mbylljen e punimeve.
 7. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Ura Vajgure.
 8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat, brenda 30 ditëve, nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Ura Vajgure, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.
 9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale si dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuara.
 10. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Berat dhe Bashkia Ura Vajgure për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

Lista e shpronësimeve për projektin "Ndërtim kopshtesh dhe ambulancash në territorin e Bashkisë
Ura Vajgurore"

Nr.	Pronar	Përshkrimi	ZK	Nr. Pasurisë	Sip. Totale m ²	Lloji i pasurisë		Çmimi Njësi	Vlera e shpronësimit	Konfirmuar ZVRPP-ja
						truall	are			
1	Agron Nazif Lika	Kopësht-ambulancë	2881	475/2	250	250		213	53250	po
2	Rrapush Qerim Mile	Ambulancë	1004	1760/9	650	50		203	10150	po
3	Xhelal Riza Xhelo	Kopësht	1093	1061/17	1400	450		206	92700	po
								Totali	156100	